



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS SË MALISHEVËS

Kuvendi i Komunës

Nr.02/ 38

Datë: 28.01.2020

PROCESVERBAL

i mbledhjes së X-të (e dhjetë) të rregulltë të Kuvendit Komunal të Malishevës

REND DITE

1. Emërimi i anëtareve të Komisionit për hartimin e Rregullores për Transparencën në Komunën e Malishevës.
2. Ndryshimi i anëtarit të Komisionit Komunal për shqyrtimin e ankesave për emërtimin e rrugëve.
3. Rishqyrtimi i vendimit 02/451 datë:22.07.2019, për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Kullës së Sefë Mleqanit në fshatin Mleqan, Komuna e Malishevës sipas kërkesës së MAPL-së nr.020-833/7 datë:16.10.2019.
4. Rishqyrtimi i vendimit 02/401 datë:04.07.2019, për hartimin e hartës zonale të Komunës së Malishevës sipas kërkesës së MAPL-së nr.020-790/21 datë: 17.10.2019.
5. Rishqyrtimi i vendimit 02/518 datë:12.09.2019, për caktimin e lokacionit për ndërtimin e shtëpisë (Odës) së pritjes si dhe ndërtimin e një parku për Komunitetin e Lagjes Buzhala të fshatit Llazicë, sipas kërkesës së MAPL-së nr.020-977/9 datë: 17.10.2019.
6. Shqyrtimi i raportit Nëntëmuor financiar i të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën Janar-Shtator 2019.
7. Shqyrtimi i Raportit të DKAE-së për përfundimin e vitit shkollor 2018/2019 dhe fillimin e vitit shkollor 2019/2020 dhe përgatitjet dimërore nëpër shkolla.
8. Shqyrtimi i Raportit të Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural rreth mbjelljeve vjeshtore .
9. Shqyrtimi i Raportit të Drejtorisë së Inspektoratit.
10. Shqyrtimi i Raportit nr.02/470 datë:19.08.2019 të Komisionit për shqyrtimin e raportit të Kompanisë "Ekoregjioni", Njësia në Malishevë për vitin 2018.
11. Shqyrtimi i kërkesës nr.06/73 datë:02.08.2019 e parashtruar nga z. Feim Kryeziu nga fshati Pagarushë, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.
12. Shqyrtimi i kërkesës nr.06/74 datë: 13.08.2019 e parashtruar nga z. Urim Mazreku nga Malisheva, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.
13. Shqyrtim i kërkesës nr.06/75 datë: 28.08.2019 e parashtruar nga z. Njazi Mazreku nga Malisheva, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.

14. Shqyrtimi i kërkesës nr.06/78 datë: 26.09.2019 e parashtruar nga z. Ali Mazreku nga Malisheva, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.
15. Të ndryshme.

Mbledhja mbahet me datë 31.10.2019 dhe filloi në ora 10:30 Të pranishëm në fillim të mbledhjes ishin 17 asambleistë, Nënkyetari, drejtorë komunalë, përfaqësuesi i OSBE-së, LMT dhe media.

Rrahim Morina: Pershendetje për të gjithë! E hapi mbledhjen e X-të të rregulltë dhe sot kemi një zëvendësim të një Këshilltari komunal të Ali Monrinës që ka dhënë dorëheqje dhe në vend të tij vjen Kushtrim Zogaj nga PDK. Po ua lexoj vendimin për emrimin e Kushtrim Zogaj për Këshilltarë Komunal...

E ftoj Kushtrimin për ta dhënë betimin.

"Unë Kushtrim Zogaj betohem ose do t'i kryej me nder, besnikëri, pa anime, e me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat dhe do të ushtroj autorizimet e mia si këshilltar i Kuvendit të Komunës së Malishevës në mënyrë që të sigurohen kushtet për jetë për të gjithë qytetarë. Betohem!"

Kushtrim Zogaj: Betohem!

Rrahim Morina: E hapi debatin jashtë rendit të ditës.

Alban Krasniqi: Pershendetje! Dua të flas sot për realizimin e buxhetit dhe Planin e Prokurimit për këtë vit sepse është shqetësues ana e planifikimit dhe të realizimit të projekteve dhe pezullimin e disa projekteve. Po i përmend tri pezullime: rregullimi i oborreve të shkollës është pezulluar dje, ndërtimi i palestrës sportive në Astrazup dhe renovimi i objektit të QKMF-së në Malishevë etj për arsyet që nuk i dimë edhe se jemi në fazën e fundvitit dhe nuk e dimë se çka do të bëhet me këto projekte. Ka shumë projekte kapitale që ende nuk janë futur si aktivitete të prokurimit.

Kërkoj nga kolegët asambleistë që të thirrjmë një mbledhje të jashtëzakonshme me një pikë pikë të veçantë për realizshmërinë e buxhetit dhe çështjet që kanë të bëjnë me tenderimin dhe realizimin e projekteve. Është mirë që të njoftohemi për këtë gjëra dhe të kërkojmë përgjegjësi për çështjet që përmenda më heret.

Muzeu i Qytetit është në terr, pa ngohje, ujë dhe internet ku është edhe biblioteka pra janë pa kushte elementare të punës. Që 5 vjet qeverisje edhe pse keni qenë të informuar për energjinë elektrike në mars ju nuk keni qenë në gjendje asgjë të bëni. Kërkoj që të bëni zgjidhje konkrete për Muzeun e Qytetit.

Valon Krasniqi: Pershendetje! Kam një pyetje për Nënkyetarin. Para 2 muajsh në faqen zyrtare të komunës ishte një lajme për 2 km asfalt që kane filluar të shtrohen në fshatin Bardh. Nënkyetar a do të shtrohen ato rrugë që kanë filluar për vitin 2019 sepse asnjë projekt që ka qenë i paraparë për fshatin tonë nuk është realizuar? Është mirë që ato rrugë të shtrohen para se moti të prishet sepse ne me disa banorë të atyre lagjeve do të organizojmë një lloj proteste për këtë çështje.

Nebih Bibaj: Pershendetje për të gjithë! Kam disa çështje. Nënkryetar rrugët në qendër të Malishevës janë në gjendje të mjerushme po thujese gjithëkund. Gjendje të tilla ka edhe nëpër fshatra gropa, këputje të asfaltit etj. Për gjendjen e rrugëve në Malishevë jeni për keqardhje.

Rrugën "Agim Çela" mirë keni bërë që e keni filluar për ta shtruar pas 6 viteve por e keni bërë të paklueshme sepse e keni shtruar veç rërën.

Ashtu edhe me labidarin veç keni filluar dhe punën e keni lënë në gjysmë, tash fillon moti me ngrica dhe më nuk mund të punohet.

Nënkryetar, pse nuk punon që 15 ditë arkivi?

Nga DKAË, kërkoj një raport për konkurset se çfarë është bërë për vitin e ri akademik. Në Vermicë nxënësit parashkollor nuk kanë edukatore, pse?

Hidajete Mazreku: Pershendetje për të gjithë! Tetori është muaji i ndërgjegjësimit për smundjen e kancerit, por neve gratë e Malishevës ka qenë zhgënjim pasi nuk jemi nuk jemi paisur me aparatën e mamografisë. Ne si VV kemi kërkuar këtë aparat në vazhdimësi që nga viti 2016, ndërsa që tri vite radhazi e kemi të planifikuar me buxhet. Nënkryetar çka është bërë në këtë drejtim? Ku qëndron fakti që pse nuk e kemi këtë aparat mamografik? Të gjitha komunat përreth janë të pajisuar me këtë aparat. Ne me Komitetin për Barazi Gjinore e kemi vendosur një postier në QMF se sa i rëndësishëm është mamografija. Kryetari ka premtuar që në muajin tetor do të jetë ky aparat pr nuk është bërë. Çka do të bëhet në të ardhmen për këtë çështje?

Shtetësimi tjetër është për transportin urban në K. e Malishevës. Ne me KDI-në kemi mbajtur një Tryezë të Rrumbullaktë për këtë çështje dhe drejtori i Financave ka premtuar që së bashku me Drejtorinë e Urbanizmit do të bëjnë diçka rreth kësaj çështje. Mirëpo nuk është bërë asgjë në këtë drejtim. Është mirë që t'i merreni parasysh rekomandimet e grave të K. së Malishevës.

Behije Sertoll: Pershendetje për të gjithë! Këtu dua ta ngrisë një shqetësim të qytetarëve të Bellenicës që më anë të një shkrese ju kanë drejtuar Kryetarit dhe Kuvendit për paknaqësitë për hapjen e një gurthyese në vendin e quajtur "Gajrak" me përmasa shumë më të mëdha se sa ai i mëherëshëm që ka operuar. Ne i dimë pasojat e këtyre gurthyesëve që janë duke operuar e që në Bellenicë 3 të operojnë është e tepërt të cilët po e shkatrojnë dhe dëmtojnë fshatin, ekosistemin etj. Kërkoj nga Kryetari që kush është kjo kompani për gurthyes që po pritët të fillojë dhe a ka marrë ndonjë leje të punës?

Ilaz Krasniqi: Pershendetje për të gjithë! Këtë shqetësim e kam nritur edhe njëherë për rrugën "Ragip Latifi" e shtruar 600m asfalt por nuk ka kanal nga ana eperme e rrugës për kullimin e ujit gjatë të reshjeve dhe e ndalon ujin që të futet në shtëpi. Këtë e kanë kërkuar edhe qytetarët direkt te Kryetari. Aty nuk është bërë ai kanal.

Në rrugën "Hilmi Hoti" pjesa e djathtë e rrugës është e dëmtuar. Ne kemi kërkuar disa herë që të rregullohet nga Drejtoria e Urbanizmit Por gjithëherë kërkesat tona po hasin në veshë të shurdhur te qeveria.

Në shkollën fillore "Ibrahim Mazreku" në Malisheve ka mungesë të higjenës dhe familjarët janë të shqetësuar për këtë. Aty duhet të merren masat e menjëhershme.

Në shkollën e Vermicës nuk ka edukatore edhe pse drejtori i Arsimit ka qenë me kohë i paralajmruar për këtë çështje. Aty ushtruesi i punës së drejtorit e kryen edhe punën e edukatorit dhe jep mësim në klasën e dytë.

Shqetësuese është për ne mësuesit me diploma flas që janë më shumë se 50-të e që kanë normë të plotë e sjellën me arrogancë të plotë, ndërsa ka mësues të kualifikuar e që e kryen ndershëm punën e që janë me gjysmë norme. Jo rastisht testi PISA na ke vendosur në fund.

Kastriot Berisha: Pershendetje për të gjithë! E uroj Kushtrimin për detyrën e re. VV i uroj fitoren që do len e para në këto zgjedhje dhe Fetah Rudit u uroj zgjedhjen për deputet në Parlamentin e Kosovës e jua mbylli gojën disave anëtarëve të PDK-së! Sa i përket atyre shqetësimeve që ngritet ju për qeverisjen në Malishevë pajtohem me ju dhe them që qytetarët e kanë dëshkuar për këtë arsye NISMA në këto zgjedhje.

Arlind Morina: Pershendetje për të gjithë! Shqetësimi im është për qentë endacakë që po rrezikojnë jetën e qytetarëve në tërë K. e Malishevës. Ka qenë një projekt në mes Drejtorisë së Bujqësisë dhe nivelit qendror për rehabilitimin e tyre. Deri ku ka shkuar ky projekt? Shqetësimi tjetër është për investimet kapitale për fshatin Astrazup pse nuk është shtruar? Pse janë heq 4 rrugë nga planifikimi? Kush është ai kapetan që po i shtin e i heq rrugët në projekt-buxhet në Astrazup?

Për drejtorin e Arsimit është bërë një kërkesë nga shkolla fillore "Ganimete Tërbeshi" për rregullimin e kalldajës e që ajo nuk është rregulluar. Atë e ka rregulluar me pagë të vet puntori teknik.

Si e prishet fushën e sportit në Dragobil e që është ndërtuar me ndjersën e nxënësve?

Sylë Dukolli: Pershendetje për të gjithë! Është hera e 4-ërt që e paraqes një kërkesë për banorët e fshatit Mleqan për kyçjen në rrugë për tokat e veta pavarësisht bisedimeve me ministrin Pal Lekaj.

Edhe për mua është shqetësuese tema për qentë endacakë dhe janë të rrezikshëm për nxënësit dhe është mirë që të merren masat e duhura sa më shpejt.

Shqetësimi tjetër është për ndriçimin publik në drejtim të Kjeves ku disa drita nuk punojnë dhe është mirë që të rregullohen ato.

Sadije Krasniqi: Pershendetje për të gjithë! Shqetësimin tim e kam shprehur edhe më heret për gjendjen e kanalizimeve në Drenoc. Në kohën kur është hartuar buxheti unë e kam shprehur këtë shqetësim dhe nuk jam pajtuar me projektet që janë ndarë për fshatin Drenoc. Gjendja pra e kanalizimeve është alarmante dhe kërkoj që menjëherë të merren masat.

Shqetësimi tjetër i imi dhe i shumë grave tjera ashtu siç e përmendi edhe profja është mamografi. Ne të gjithë kemi pritur që ky aparat i mamografisë të vije në muajin tetor.

Komiteti për Barazi Gjinore nuk është duke punuar në bazë të planit që e ka mirtuar vet. Kryesuesja e këtij komiteti është nga VV e cila nuk thirret mbledhje për këtë komitet. Ne jemi në muajin nëntor dhe kemi mbajtur 1 mbledhje të rregulltë dhe 2 të jashtëzakonshme. Andaj kërkoj nga kolegët e VV që të bisedojnë me të dhe pres një reflektim të tyre.

Alban Mazreku: Pershendetje për të gjithë! Kam një çështje për të ngritur për Çershën e fëmijëve sepse aty po marrin fëmijë të atyre që asnjëri prind nuk punon, ndërsa nuk i marrin ata fëmijë të moshës 2-3 vjeçare e që ju punojnë të dy prindërit. Drejtor, pse ndodh kjo?!

Kastriot, urime edhe juve për rezultatin e arritur në këto zgjedhje dhe të bëjë thirrje që të kthehesh sërish tek partia ku ke qenë!

Valon, është viti i dytë që rruga që është nga Ura e Madhe e që shkon në drejtim të minitransitit është ndarë buxheti edhe në vitin 2018 edhe këtë 2019 por ajo rrugu nuk është bërë. Ku po shkojnë ato mjete?!

E përmendët këtu mamografinë për të cilën që 2 herë po ndajmë buxhet por ajo nuk është blerë, pra është për t'u ardhur keq!

Çështja e mbeturinave është shqetësuese sepse si të dalësh nga dera e komunës e në të gjithë qytetin ke mbeturina në rrugë.

Hajdin Berisha: Pershendetje për të gjithë! Alban, e di që janë pezulluar disa projekte të prokurimit, por realisht nuk kam ende një pasqyrë të qartë se pse janë anuluar ato. Besoj që do t'ju njoftojmë me kohë. Çështja e Muzeut nuk duhet të mbetet ashtu siç është dhe ajo gjendje do të rregullohet në mënyrë urgjente.

Valon, në Bardh ka pasur projekte që janë realizuar. Në këtë vit është realizuar një pjesë e mirë e projektit të kanalizimit, janë kryer edhe disa pjesë të shkollës. Ndërsa sa i përket rrugëve janë projekte 2-vjeçare besoj që do të përfundojnë me kohë.

Sa i përket mamografit, mjetet janë ndarë por ka një pengesë sipas Statutit të QKMF-së sepse ajo nuk e ka një adekuat dhe të bazuar në ligje. Ka një Statut që është në fuqi prej rregulloreve të UNMIK-ut. Ky është faji direkt i Ministrisë sepse ajo e bënë një të tillë e bjen këtu për miratim. Mamografi është i domosdoshëm në Malishevë edhe pse nuk e di a kemi kuadër për të.

Behije, çështja e gurthyesit në Gajrak edhe pse ka një kërkesë për të Kryetari ka refuzuar që të jap një pëlqim të tillë. Për përgjigje dhe detaje tjera drejtorët i kanë sjellë raportet dhe ata mund t'ju përgjigjen ashtu siç është më së miri.

Blerim Thaçi: Pershendetje për të gjithë! Nebih, konkurset janë publike dhe nuk janë të përfshira në raport, por nese doni ne mund t'i sjellim për një mbledhje tjetër.

Çështja e Vërmicës ka disa procedura të cilat për t'i ndjekur të gjitha duhet kohë. Ajo ka lajmruar që nga 1 tetori nuk vije më në punë. Ne kemi shpallur konkurs, jemi në procedura.

Ilaz, kemi intrnuar në pastërtinë në shkollën fillore "Ibrahim Mazreku" dhe pastërtia është dukshëm më e mirë.

Alban, për Çerdhe kemi shumë kërkesa dhe procedurat e përzgjedhjes së fëmijëve e bënë vet çerdhja. Ne nuk kemi asnjë kërkesë me shkrim për rastet që përmende.

Rrahim Morina: Kalojmë për debatin për rendin e ditës. Materialin e keni marrë me kohë. Unë kërkoj që t'i shtojmë edhe 2 pika të rendit të ditës. Një pikë ka ardhur pasi e kemi shpërndarë materialin. Çështja ka të bëjë me anulimin e vendimit për ndryshim të lokacionit për ndërtimin e çerdhës në Kjejë. Është vendimi i 4-ërt që kthohet nga MAPL-ja për shkak që ekzekutivi nuk e ka paraparë në preambulë dhe nuk është përshtatur me PZHK-në.

Pika e dytë është për pagesën e së anëtarëve të Komisionit për dëgjimin publik për buxhetin 2020-2022 me theks të veçantë për vitin 2020. Këto janë propozimet e mia.

E hapi debatin për rendin e ditës. Mbase s'ka debat. I hedhi në votim 2 pikat që i propozova unë dhe të renditen si pika e 6-të dhe e 7-të. Kush është për?

Për: 22

Kundër: 0

Abstenim: 0

E hodhi rendin e ditës në tërësi i plotësuar me këto dy pika. Kush është për?

Për: 22 (unanimisht).

Kalojmë në pikën e 1-rë të rendit të ditës: Emërimi i anëtareve të Komisionit për hartimin e Rregullores për Transparencën në Komunën e Malishevës. Propozoj që ky komision t'i ketë 5 anëtarë, pra nga 1 anëtarë nga secili grup. A po pajtoheni që ky komision t'i ketë 5 anëtarë?

Për: unanimisht

Shkojmë me propozimet.

Sylë Dukolli: Ne grupi ynë propozojmë për këtë komision Abetare Limaj.

Alban Mazreku: PKD-ja propozon Nebih Bibaj.

Valon Krasniqi: Ne grupi i LDK-së propozojmë Arlind Morinën.

Alban Krasniqi: Ne VV propozojmë Prenton Kryeziun.

Rrahim Morina: Mbase s'ka këshilltarë të AAK-së sot këtu po e lëmë Kastriotin pastaj që do të ndryshojë mundet. Atëherë kush është pro që këta emra të propozuar të jenë anëtarë të këtij komisioni?

Për: unanimisht

Me këtë votim konstituohet Komisioni për Hartimin e Rregullores për Transparencë në K. e Malishevës.

Kalojmë në pikën e 2-të të rendit të ditës: Ndryshimi i anëtarit të Komisionit Komunal për shqyrtimin e ankesave për emërtimin e rrugëve. Kërkesa është nga Kryesuesi i këtij Komisioni Ali Morina i cili ka kërkuar që të zëvendsohet Kushtrimi nga LDK-ja për shkak të mungesës së vazhdueshme.

Valon Krasniqi: Grupi ynë propozon që Kushtrim Morina të zëvendsohet me Kryesuesin e Kuvendit z. Rrahim Morina;

Rrahim Morina: Shkojmë në votim. Kush është pro që Rrahim Morina të jetë anëtar i Komisionit Komisionit Komunal për shqyrtimin e ankesave për emërtimin e rrugëve?

Për: unanimisht

Në të gjitha vendimet që i ka kthyer MAPL-ja është plotësimi në preambulë i Ligjit për Planifikim Hapësiror e të jetë në harmoni me PZHK-në. Për sqarime Muharremi.

Muharrem Morina: Pershendetje! MAPL-ja ka kërkuar që vendimi duhet të jetë në pajtim me ligjin. Dokumentet strategjike që ka hartuar komuna siç është PZHK-ja me të cilin nuk jeni konsultu. Çdo herë kur merrni vendim për ndërtim në hapësirat publike e që nuk janë të parapara edhe në PZHK ata kanë për t'i kthyer mbrapa. Pra na njëherë duhet ta shikojmë PZHK-në e pastaj të marrim vendimin për ndërtime publike.

Alban Krasniqi: Kur u pat miratu PZHK-ja ne patëm kërkuar një takim informues dhe këshillues për PZHK-në nga Drejtoria e Urbanizimit. Ai takim nuk u mbajt dhe ne prandaj sot kemi këto joinformata. Pra kjo është si rrjedhojë e një neglizhence të qeverisë e të drejtorit në këtë rast të cilat të gjitha pikat kanë të bëjnë me të. Kjo në këtë rast i përket drejtorit të Urbanizimit.

Rrahim Morina: Ne ndoshta mund të marrim një vendim që t'i autorizojmë drejtorët që t'i harmonizojnë këto 4 vendime sipas ligjeve ashtu siç ka kërkuar ministria e pastaj ti përcjellim përsëri në MAPL.

Muharrem Morina: Edhe drejtorja nuk ka faj. S'po e mbrojë. Para PZHK-së është dashur të miratohen hartat zonale dhe Plan Urbanistik. Me këto 2-ja ju këtu më nuk do të merrni vendime për ndërrim destinim sepse me Plan Urbanistik e shëndërroni tokën bujqësore në atë ndërtimore. Mbase nuk ajnë këto 2 dokumente në këtë rast nuk ka ditur se si të veprojë edhe drejtori.

Hidajete Mazreku: Ditën kur është marrë vendimi unë e kam thënë që duhet me këtë të merret përsipër PZHK-ja. Kam sygjerruar që kërkesat për ndërrim destinim më mos të vijnë këtu. Këto kanë shkuar por në të ardhmën ju lutem që të gjitha kërkesat të shkojnë tek Kryetari e ai i t'i drejtojë për Urbanizëm për detaje tjera e pastaj t'i jepet leja.

Rrahim Morina: Janë 4 kërkesa e të gjitha janë të natyrës së njëjtë e që kërkohet që të harmonizohen me ligjet. Prandaj ne të kërkojmë nga Drejtoria e Urbanizmit që t'i harmonizojë këto e t'i përcjellë për MAPL. Atëherë kush është për?

Për: 21

Kundër: 1

Abstenim: 1

Shkojmë në pushimin e drekës, kthehemi në ora 13:15.

Pas pushimit e vazhdojmë aty ku e lamë. Kalojmë në pikën e 7-të të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi për kompenzimin e anëtarëve komunal të Komisionit për mbajtjen e dëgjimit publik të propozim buxhetit për vitin 2020. Kjo është një akcesë e këtyre anëtarëve dhe ne e kemi një tarif të caktuar, për terrenin 20€ dhe për mbledhjet në zyre është 50€. E hapi debatin për këtë pikë.

Mbase s'ka debatues e hedhi në votim këtë kërkesë. Kush është për?

Për: 15

Kundër: 1

Abstenim: 5

Kalojmë në pikën e 8-të të rendit të ditës: Shqyrtimi i raportit Nëntëmuor financiar i të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën Janar-Shtator 2019. Drejtori e ka fjalën.

Valon Mazreku: Pershendetje për të gjithë! Do ta pasqyrojë në pika të shkurtëra Raportin Financiar për këtë periudhë. Bazuar në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike, Drejtoria për Buxhet dhe Financa ka përgatitur këtë raport financiar në bazë të standardeve të kontabilitetit dhe procedurave të thesarit mbi të hyrat dhe shpenzimet e ndodhura në këtë periudhë.

Në bazë të dhënave të prezantuara në tabelat përkatëse në këtë raport rezulton se Komuna e Malishevës ka një buxhet të miratuar nga Kuvendi Komunal për vitin 2019 me shumën 14,392,379.89€ për të gjitha programet dhe nënprogramet. Kur kësaj shumë i shtohen bartjet e disa shumave të vogla të mbetura nga donacionet e viteve të kaluara në vlerë prej 1,140.35€, del se shuma totale e buxhetit të regjistruar në SMFP për K. e Malishevës në fund të vitit fiskal arrijnë vlerën 14,393,520.24€.

Buxheti i alokuar për këtë periudhë Janar-Shtator 11,729,242.32€ që d.m.th që shkalla e realizimit të buxhetit në total është 82%. Sipas shënimeve të librave të thesarit del që shkalla e

shpenzimit të buxhetit të realizuar për këtë periudhë është 84%. Kurse përqindja e tërësishme e buxhetit të shpenzuar për këtë periudhë është 69%.

Në faqet në vazhdim janë dhënë tabelat e planit të buxhetit realizimi, shpenzimi sipas programeve, sipas burimeve, sipas kategorive ekonomike në mënyrë sintetike dhe analitike për periudhën Janar- Shtator 2019.

Sipas buxhetit të K.së Malishevës për vitin 2019 nga të hyrat vetanake janë planifikuar të inkasohen 921,023.00€. Plani i realizimit i të hyrave vetanake për këtë periudhë është të hyra të rregullta 577,479.74€, kurse të hyrat të cilat inkasohen nga gjobat e gjkatave dhe gjobat nga trafiku për këtë periudhë janë 21,440.00€, kurse gjobat në trafik janë 132,229.50€ e që në total janë 731,149.24€.

Pra kjo është paraqitja në pika të shkurtëra e këtij raporti.

Rrahim Morina: E hapi debatin për këtë pikë.

Sylë Dukolli: Po mendoj që me këto raporte po e ngarkojmë mbledhjen shumë pasi që më vonë është edhe raportit i Kryetarit dhe aty janë të përfshira edhe këto.

Në këtë raport në sy me ranë investimet kapitale që ajnë të shpenzuara 95.5%, pra nuk ka mbetë asgjë për këtë fazën e vonshme pra të gjitha procedurat e prokurimit janë bërë më kohë. Për t'u lavdëruar është edhe realizimi i të hyrave vetanke diku 78% . pra në përgjithësi raporti është i përgatitur mirë dhe i detjuar nëpër tabela.

Hashim Vrenezi: Pershendetje për të gjithë! Është realitet që raportet janë të përgatitura pak më mirë, por jo mirë janë puntë në terren. Në raportimet e mëhershme kemi kërkuar sqarime shtesë e drejtori ka pas premtuar që do t'i sjellë lstat për shërbimet kontraktuese tjera. Kërkoj që edhe sot ta sillni listen se si është shpenzuar ky zë buxhetor.

Rritje ka e që dua sqarime shtesë:

-te zëri buxhetor shërbime të ndryshme intelektuale dhe

-regjistrimi i automjeteve

-vendime gjyësore etj.

Te finacimi i ndërmarrjeve prodhuese bujqësore e që është e shpenzuar 100%. Cilat janë ato ndërmarrje që financuar e që është shpenzuar në tërsi buxheti i ndarë? Cilët janë ata fermerë që kanë përfituar traktorë?

Ajo që tha Nënkrjetrai që projektet e rrugëve janë dyvjeçare nuk qëndron. Ne dim që ka rrugë siç është rruga "Mulla Selimi" në Marali që është një projekt 1 vjeçar e që duhet mbrenda vitit të përfundojë. Pra, nuk ka asnjë bazë që rrugët janë projekte 2 vjeçare. Këtu ka keqpërdorim të buxhetit dhe devijime të projekteve dhe për këtë ne i kemi raportuar në krimet ekonomike.

Kam një pyetje direkt për Nënkrjetarin. Kolektori i ujërave të zeza Marali-Pagarushë 3000m kanalizim ka qenë i projektuar që të ndodh më heret por nuk ka ndodh. A do të ndodh sivjet a jo? Po ashtu në këtë vit ka qenë i planifikuar edhe ndërtimi i parkut në Marali. A do të kryhet sivjet edhe ky projekt? Etj. Pse janë këto vonesa kaq të mëdha?

Hidajete Mazreku: Ky raport është i përgatitur me tabela e i definuar sa i përket shpenzimeve.

Por, këto shpenzime ku kanë shkuar nuk janë të qarta. 5000€ janë tek shërbime dhe mallëra janë për komunitetet por nuk e dimë se ku kanë shkuar?

Te investimet kapitale 98% është shpenzuar buxheti. Ku janë shpenzuar ato mjete edhe pse e dimë se shumë tendere janë anuluar? Ato tendere që janë anuluar a i kanë marrë ato të hollat?

Për planifikim hapësiror dhe mjedis janë shpenzuar 1,563,000.00€. Ku janë shpenzuar këto? Te subvencione dhe transfere, tek shëndetësa primare janë 540,000.00€ e që ajnë shpenzuar 100% . Ku janë bërë këto investime?

Subvencione dhe transfere, tek arsimi janë 45,000.00€. Ku janë bërë këto investime?

Shërbime teknike intelektuale janë 54,000.00€. Cilat shërbime janë ato?

Tani dua sqarime për furnizim me pije, dreka zyrtare, paisje tjera, vendime gjyqësore etj.

Valon, çfarë është bërë me transportin urban?

Arlind Morina: Drejtor, për ndërtimin e palestrës sportive në Astrazup janë të shpenzuar rreth 40,000€ diku 27% e buxhetit të planifikuar, por ne e dimë që në Astrazup nuk ka filluar ende asgjë. Ku janë shkuar ato para?

Rrahim Morina: Sa i përket vendimeve gjyqësore për çdo rast pyetet Drejtoria e Financave se ku me i marrë ato para. Nëse drejtoria nuk ju jep përgjegjie ata i marrin ku të duan, sepse 15,000.00€ janë marrë nga Kuvendi.

Ndërsa sa i përket planifikimit dhe realizushmërisë së projekteve këta më qëllim i vonojnë procedura që më vonë t'i devijojnë ato projekte siç është rasti i rrugëve që po thojnë janë projekte 2 vjeçare kur ne këtu i kemi votuar si projekte 1 vjeçare.

Në vazhdimësi i përmendi të hyrat në arsim. Këtu kurrë s'ka të hyra në arsim e na e dimë që ka të hyra e sidomos në shkollën e mesme. Ku janë ato para?

Kërkoj nga qeveria komunale që të jetë më e kujdesshme në shpenzimin e parasë publike si dhe në realizimin e projekteve që janë të planifikuara e të votuara këtu.

Alban Krasniqi: Sa i përket këtij raporti dhe shpenzimit të parasë publike shumica nga prafolësit u përmendën por unë po i përmend veç dy te sektori i bujqësisë ku bëhen shumë shkelje. Tani jemi pothuajse në përfundimin e të mbjellurave vjeshtore e ku Kuvendi ka ndarë një shumë të caktuar për t'i ndihmuar fermerët me fara dhe plehra diku 50,000.00€. Deri me tani nuk është ndarë asgjë, të paktën nuk ka pasur asnjë tender e këtu po figuron 100% shumica e realizuar. Pra, për cilën qëllim janë shpenzuar këto para?

Është planifikuar ndarja e traktorit për fermerët, ama kjo nuk ka ndodh. Parat janë shpenzuar, për çka janë shpenzuar ato para?

Uën kërkoj që të mbahet një mbledhje e jashtëzakonshme që të diskutojmë për raportin dhe shpenzimet konkrete se ku kanë shkuar këto mjete si dhe për çështjet e prokurimit. Mendoj që ky është fake raport sepse nuk përkon gjendja reale me këtë që keni paraqitur këtu. Kjo nuk do të kalojë në heshtje sepse s'mund t'i mbyll sytë para një krimi pontencial.

Kërkoj gjithashtu 5 min pauzë që pasi të kryhet kjo pikë e rendit të ditës e të dakordohemi për një mbledhje të jashtëzakonshme që të diskutojmë për temat që i ngrita më parë.

Rrahim Morina: Po ju jap një informacion për anëtarët e KPF-së. Jeni të ftuar me datën 1 nëtor 2019 në restorantin "La villa" në Gjakovë duke filluar në ora 9:00 i organizuar nga Asocacioni i Komunave.

Mbas s'ka debatues të tjerë atëherë drejtori e ka fjalën për përgjigjie të pyetjeve që ju kanë bërë.

Valon Mazreku: Sylë, tek investimet kapitale 95.5% nënkupton që parat i kemi pasur në dispozicion për t'i zotuar dhe për t'i udhëhequr procedurat e prokurimit.

Hashim, për shpenzimet tjera kontraktuese e kemi diskutuar këtë temë disa herë dhe aq herë e kam sqaruar. Këtu ka shpenzime të higjenës, për OJQ-të që kanë aplikuar në Drejtorinë e Kulturës, transportete të ndryshme, kontrata mbi vepër etj.

Te shërbimet intelektuale e këshillëdhënese janë ato shpenzime që 99% që paguhet komisionet dhe komitetet që janë të Kuvendit Komunal.

U shtu numri i veturave biles 2 janë ble në shëndetësi prandaj është rrit edhe shuma për regjistrimin e tyre.

Sa i përket vendimeve gjyqësore e kam raportin që e kam nxjerrë se cilat kategori buxhetore janë prekur nga to dhe sa janë dëmtu. Këto vendime gjyqësore janë edhe nga vitet më hershme që nga 2013. Këto i kam të detajuara. Raporti është real ashtu siç ka ndodh shpenzimi.

Mjetet që janë ndarë për sektorin e bujqësisë janë shpenzuar për bujqësi. Në mënyrë të detajuar se ku janë shpenzuar përgjigjen mund t'ua sjellë me shkrim, sepse veç kontrata për shtalla ka qenë 2 herë më e madhe se sa ka pasur buxhet.

Sa i përket kanalizimeve nuk kam informacione si ashtu për Kjeven dhe atë Marali-Pagarushë. Mund ta pyetni drejtorin e Urbanizmit për këtë.

Hidajete, mund ta nxjerr raportin e detajuar për Zyrën për Komunitete dhe për çfarë janë shpenzuar ato para. Ndërsa sa i përket investime kapitale janë alokuar 98% jo që janë shpenzuar. Kurse sa i përket subvencioneve për Kulturë dhe Arsim ato e japin raportin se për ku janë shpenzuar ato mjete.

Furnizimi me ushqim dhe pije, jo drekë zyrtare këtu kryesisht paguhet për çerdhe dhe për kiflet për nivelin fillor.

Transporti urban nuk e di që unë jam ngarkuar për ta bërë projektin e fiziobilitetit, unë nuk jam inxhinier. Kur e rugullojmë planin urban e shohim edhe transportin urban.

Arlind, Palestina e Sporteve është në procesin e vlerësimit të zyra e prokurimit dhe në cilën fazë të vlerësimit është nuk e di. Ajo shumë është marr aty nga vendimet gjyqësore.

Ju mund të mbani mbledhje dhe mund të kërkonit raporte të detajizuara unë jam gati të bashkëpunojë me ju, por ka gjëra që është jo në autoritetin tonë.

Rrahim Morina: Kalojmë në pikën e 9-të rendit të ditës: Shqyrtimi i Raportit të DKAE-së për përfundimin e vitit shkollor 2018/2019 dhe fillimin e vitit shkollor 2019/2020 dhe përgatitjet dimërore nëpër shkolla. Drejtori e ka fjalën për paraqitjen e raportit.

Blerim Thaçi: Drejtorja e Arsimit është angazhuar për mbarëvajtjen e mësimin pavarësisht sfidave që ka pasur në këtë vit shkollor përfshirë edhe grevën që ka qenë si pengesë në mësimin e rregullt.

Unë nuk do t'ju mërzisë shumë me paraqitjen e raportit sepse kjo pikë ka kohë që po shtyhet dhe ju keni pasur mjaftueshëm kohë për ta analizuar. Nëse keni pyetje ose paqartësi unë jam këtu gati për të bashkëbiseduar me ju.

Edhe ne kemi paknaqësi të kjo çështje e mësimdhënësëve me diploma false por gjykata nuk ka marr asnjë vendim për ta, tani ata po i mbron edhe kontrata kolektive dhe ju ka dhanë mundësia e rikualifikimit. Pra, sfida kemi edhe ne.

Rrahim Morina: E hapi debatin për këtë pikë.

Valon Krasniqi: Kam disa shqetësime lidhur me shkollën tonë. Disa nxënës shkollën "Afrim Krasniqi" të disa lagjeve e sidomos ajo e "Berishajve" shkollën e kanë shumë larg. A keni

paraparë diçka për transportin e këtyre nxënësve. Brengosese është edhe jo shtrimi i trotuarit edhe pse ka qenë i paraparë diku 900m. Mos përfundimi i këtij projekti paraqet rrezik për nxënësit gjatë kohës kur rrugëtojnë për në shkollë.

Behije Sertolli: Ky raport është përgatitur për mbledhje më parë por sot i erdhi koha për t'u shqyrtuar. Ky raport në disa pika nuk përkon me atë se çfarë është në realitetin. Këto raporte ndonjëherë po zbukurohen.

Në këtë raport nuk është pasqyruar zëvendësimi i mësimdhënësve lehona e që ka shumë ankesa që nuk janë paguar. Ku qëndron arsyeja që s'janë paguar edhe pse kontratën e kanë të nënshkruar?

Ka raste kur furnizimi për shkolla si për paisje sportive është i buxhetuar por shkollat nuk furnizohen me ato paisje të nevojshme.

Si u realizua plani mësimor kur greva zgjati goxha si shumë? Për këtë më shumë i referohem gjimnazit i cili me 3 javë vonesë ka filluar mësimin, plus greva, plus ekskurzoni që zgjat 1 javë e në fund nxënësit hynë në Provimin e Maturës. Si do të përgjigjen nxënësit për ato tema që s'janë realizuar? Kush është fajtori? Afër gjimnazit operojnë shumë lokale të dyshimta, nxënësit kanë shumë mungesa. Ku shkojnë këta nxënës mbrenda procesit mësimor dhe gjatë pushimit? A keni marrë masa për këto lokale, dhe a keni bërë ndonjë denocim në polici?

Në buxhetin e komunës ndahen mjete për OJQ të ndryshme, ndërsa nëpër shkolla mungojnë bibliotekat, ndërsa aty ku ka biblioteka mungojnë librat siç është rasti në bibliotekën e Bellanicës që pre komunizmit nuk është furnizuar me libra nga Drejtoria e Arsimit, përveç furnizimit vetanak e që mund mos me qenë letrare ato libra. Kjo duhet të përkrahen e jo OJQ-të. Pra kërkoj që të ndahen mjetet me buxhet edhe për biblioteka.

Sipas kurrikulës na duhet që të bëjmë shumë kopje, por fotokopjet nëpër shkolla nuk bëjnë, komuna nuk i mirëmbanë ato.

Nebih Bibaj: Puna e fotokopjeve dhe higjiena është problem për të gjitha shkollat. Fusha e sportit në Kjeve është në gjendje të mjerushme, drejtor duhet ta rregulloni atë.

Bartja e nxënësve për lagjën "Lahaj" në Tërpezë duhet të bëhet sepse është larg, duhet t'ju sigurohet transporti sepse ata rrezikohen nga qentë endacakë. Një të janë edhe nxënësit e lagjës "Zymeravitëve" në Carrallukë. Është mirë që t'ju sigurohet transporti edhe atyre.

Ne me buxhet kemi ndarë edhe paisjen e disa shkollave me kabinete. Drejtor, a është paisur ndonjë shkollë me kabinete?

Shkolla e re në Lladroc a do lëshohet për përdorim në këtë vit. A ju keni siguruar ujë të mjaftueshëm? Mendoj që uji ka me qenë problem.

Raimonda Krasniqi: Pershendetje për të gjithë! Do të mundohem që mos t'i përsëris ato që diskutuan parafolësit. Raporti i Arsimit është pasqyrë e punës arsimore në nivel komunal dhe në radhë të parë do cilësi e më pas sasi në masën e duhur.

Drejtori e ka nisur raportin me shqetësimin për mosmbajtjen e disa ditëve të mësimin për shkak të grevës së mësimdhënësve e që është e pranueshme, por a ka ndërmar diçka DKA E-ja për humbjen e këtyre orëve e që kanë lënë pa përfshirë shumë njësi arsimore e që nxënësit kanë mbajtur teste të arritshmërisë e ju kanë rënë pyetje prej këtyre njësive mësimore?

Në faqen 3, përmendet aktiviteti me Zyrën e Koordinatorit Nacional për Kultur, Rini dhe Sport. Nuk ka qenë bashkëpunim i veçantë sepse ka qenë në gjithë Kosovën. Por shifrat për arritjen e sukseseve nuk janë shkruar. Do të ishte mirë që të rezultonin nxënësit fitues në cilin do nivel

shkollor. Nëse do të përmendëshin emrat e nxënësve fitues kjo të shërbente jo vetëm për ta si fitues, por edhe për të stimuluar dhe nxitur nxënës të tjerë për të marrë pjesë në garat ndryshme. E shfrytëtoj rastin që t'i uroj nxënësit fitues të shkollës "Hasan Prishtina" sidomos nënësin Altin Krasniqi që ka dalë fitues në Histori në nivel komunal dhe e falemnderoj vetën time sepse DKA-ja nuk e ka konsideruar asnjëherë të vlefshme punën time për t'më plotësuar normën edhe pse që 17 vjet kontribuoj në arsim e nxënësit e mi kanë fituar çmime si në Kosovë ashtu edhe në Shqipëri. DKA-ja e sheh të arsyeshme që të punësojë me normë të plotë mbi 80 mësimdhënës që janë me diploma falso.

Po ashtu në faqen 3, në fund, shkruan që janë realizuar shumë projekte e shumë punë përgatitore. Sa janë realizuar, përmendni? Në cilat shkolla janë këto projekte?

Në faqen 5, në paragrafin e dytë në shkollën e re në Lladroc pse s'ka nisur mësimi edhe pse është shkruar që puntë përfundimtare janë duke u bërë?

Në fund të faqes së 5-të, shkruan: është përkrahur furnizimi me paisje mësimore për nxënësit me kushte të rënda ekonomike. Sa është numri i saktë i këtyre nxënësve? Cilët janë këta nxënës me emra?

Në faqen 6, vizita në shkollë me karakter monitorues. A është bërë monitorimi në orë mësimore për mësimdhënësit? Nëse po. Si janë monitoruar këta mësimdhënës që aknë punuar me klasat e para, të dyta, të gjashta dhe të shtata kur tekste shkollore sipas Kurrikulës së Republikës së Kosovës nuk ka pasur?

Shumë shqetësuese merret fakti i braktisjes së shkollës në faqen 12 të raportit. Aty thuhet që 206 nxënës braktisën shkollën në gjysmëvjetorin e II-të në arsimi 9-vjeçar, ndërsa në faqen 13 lëvizja e nxënësve janë 131 në fund të gjysmëvjetorit të I-rë. Është bërë një gabim i vogël në statistikë. Vlerësoj punën e DKA-së që në raport e ka përfshirë edhe rezultat e Testit të Arritshmërisë për klasat e IX-ta. Sa është real ky rezultat ne nuk e dimë kur nxënësit kanë pasur mugesë të orëve mësimore për shkaqet që përmenda më heret.

Në faqen 20, tek orët e pambajtura për arsimin fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë, a janë futur edhe orët që i përkasin grevës sepse numri është shumë i madh dhe shqetësues?

Po në këtë faqe, nxënësit që kanë braktisur shkollën është në kundërtënie me shifrat e faqës 12 dhe 13 sepse këtu thuhet gjithësej 74 nxënës kanë braktisur shkollën, 9 nx. për arsye të panjohura, disa për pengesa nga prindërit a në të vërtetë në faqen 12 dhe 13 është paraqitur për ciklin e mesëm të ulët 206 dhe parafillor 131.

Në faqen 24, tek renovimi është futur edhe shkolla "Hasan Prishtina". A është kryer ndonjë renovim deri tani sepse raporti ka ardhur në gusht e ne jemi në tetor? Nëse nuk ka filluar ndonjë renovim çfarë është paraparë të renovohet sepse shqetësuese është çatia e cila po pikon në katin e dytë të shkollës dhe po mbushet me ujë korridorit?

Në mbledhje e KPF-së kam kërkuar që drejtori t'na sjellë konkurset sepse në veb-faqen e komunës jepen formalisht njoftimi që ka qenë një konkurs ndërsa është hequr materiali i konkursit. Megjithatë një konkurs e kam printuar. Në këtë konkurs nuk figuron konkursi për drejtor në shkollën fillore "Ibrahim Mazreku". Pse nuk është shpallur konkursi për këtë shkollë kur drejtori është pensionuar në qershor? Drejtor ju e dini shumë mirë që me Ligjin e Arsimit 3 muaj para se të del në pension duhet të hapet konkursi për drejtor. për këtë ka ardhur një kërkesë nga Këshilli i Shkollës dhe kanë kërkuar që të shpallet konkurs e ju nuk e keni marrë parasysh dhe as nuk ju keni kthyer përgjigje. A ka aktualisht drejtor shkolla "Ibrahim Mazreku", nëse ka, ka ushtrues detyre atëherë? Kur mendoni të shpallni konkurs?

Blerim Thaçi: Valon, sa i përketë transportit të nxënësve asnjë institucion nuk mund të veprojë jashtëligjshëm. Me ligj është e përcaktuar qarkorja 4 km edhe pse është e nevojshme. Behije, për pagesat e lehonave shqetësim është edhe për ne sepse ligji planifikon 3% lindje ndërsa numri është më i madh i lehonave.

Shqetësuese është edhe numri i vogël i nxënësve që çdo ditë po bie. Rrezikojnë shkollat në Berishë, Mirushë. Është e dhimbshme sot të mbyllet një shkollë.

Në raport janë të përfshira edhe orët e humbura gjatë grevës ndërsa sa i përketë gjimnazit dy javë janë të humbura të mësimit por janë zëvendësuar të shtuanve ato ditë përveç dy ditëve.

Ne bashkëpunojmë me Policinë në Malishevë dhe së bashku me Inspektoriatin kanë për inspektime dhe kontrolla të atyre lokaliteteve.

Ne kemi mugesë të buxhetit për t'i furnizuar bibliotekat me libra. Ne përmes donacioneve të ndryshme mundohemi që ta mbulojmë këtë çështje.

Sa i përketë çështjes së fotokopjeve e di që shkollat kanë probleme por ne po kemi problem me kontraktorin dhe do të mundohem që ta rregulloj këtë çështje.

Fusha sportive në Kjeve mendoj që këtë vit do të përfundojë. Shkolla në Lladroc ka përfunduar dhe është e gatshme për mësim por po presim deri sa të rregullohet edhe oborri i shkollës.

Për braktisjen e nxënësve kemi folur shumë por aty përfshiet edhe lëvizja e mbrendshme dhe ajo e jashtme e nxënësve. Kjo braktisje e shkollës nga nënësit këtë vit është më e vogël krahasuar me vitin e kaluar.

Aktualisht janë 6 ushtrues detyre të drejtorëve nëpër shkolla edhe shkolla fillore "Ibrahim Mazreku" ka ushtrues detyre të drejtorit. Problemi nuk qëndron tek ne, por vendet e punës po na cakton Ministria e Administratës sepse së pari duhet me ba kërkesë për shpalljen e konkursit. Mendoj që shumë shpejt do t'na kthehet përgjigja dhe do t'i shpallim këto vende për drejtorë. Po ju saqroj këtë procedurë... Falemnderit!

Alban Krasniqi: Drejtor, këndëshm po flisni por gjendja në arsim është e keqe. Duhet të ndërrohet edhe formati se si po bëhen këto raportime sepse s'ka ndonjë raport që a po zgjidhet ndonjë çështje që po e diskutojmë këtu. Drejtor përgjigje të këndshme na dhe për fushat e sportit për shkolla, por a e din që tepihu i fushës së sportit të Vërmicës është që 2 vjet mbas shkollës, pra tenderimi ka ndodh por jo edhe realizimi i projektit? Kjo është reale. Kjo është gjendje e keqe. Kësë gjendje është në Kjevës.

Nuk ka renovime të thella nëpër shkolla që po thoni projekte 2 vjeçare kur ato mund të kryhen mbrenda pushimit të mësimit. Ne kemi ndarë mjete për higjenën por rezultatet nuk po shihen. Kjo gjendje e higjenës është e mjerushme nëpër shkolla. Ky është dështim i juaji sepse ka raste kur nuk ka as ujë nëpër shkolla. Kjo është bazikja, harroni trajnimet kur ka një nivel të tillë. Po flet për politika të larta këtu, gjë që s'na takon neve, kur më mirë do të ishte të merreshim me problemet që i kemi këtu. Sot shumica e shkollave kundërmojnë, pa e hequr këtë mos flisni për kualitet. Kjo është turturë për nxënësit ato ambiente. Nuk mund të flas për tjerat pa i rregullu këto. Është mirë që të gjejmë zgjidhje, hajde me një plan të përgjithëshëm për zhvillimin e arsimit në të gjitha fushat dhe sektoret. Kjo është detyra jote si drejtor, në fund të fundit jep dorëheqje sepse nuk është turp. Dorëheqja është akti më i mirë mund ta bësh nëse nuk realizohen çështjet për rregullimin dhe përmirësimin e gjendjes në arsim.

Rrahim Morina. Kam një kërkesë për ju anëtarë të Kuvendit. Janë 4 kërkesa për ndërrim-destinim të tokës bujqësore në ndërtimore. T'i votojmë edhe këto kërkesa pastaj ato 3 pika të mbetura të rendit të ditës i përcjellim për mbledhjen tjetër. Edhe këtë herë po e autorizojmë

Urbanizmin që t'i përshtat me PZHK-në e më pas t'i përcjellim për MAPL. Kush është për që të miratohen këto 4 kërkesa për ndërrim destinim të tokës bujqësore në atë ndërtimore. Po i hedhi në pako. Kush është për?

Për: 17

Kundër: 0

Abstenim: 1

Me këtë votim aprovohen kërkesat për ndërrim- destinim të tokës bujqësore të Feim Kryeziut, Urim Mazrekut, Nijazi Mazrekut dhe Ali Mazrekut.

Duke ju falënderuar për pjesëmarrje me kaq mbledhjen e shpalli të mbyllur.

Mbledhja përfundoi në ora: 15:55

Procesmbajtësi: Samir Krasniqi

Kryesuesi i Kuvendit: Rrahim Morina